

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

11/3/2022

LOERMA SHPK

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

1.1 Të përgjithëshme

2. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

3. PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT

3.1 Pozita gjeografike

3.2 Klima

3.3 Arkeologjia

3.4 Burimet ujore

3.5 Flora dhe Fauna

4. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Profili i propozuesit

4.2 Informacin per qendrat e banuara (distanca nga qendrat e banuara dhe njësia e qeverisjes vendore që administron territorin ku zhvillohet projekti)

4.3 Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit)

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

5.1 Ndikimet nga zhurma

5.2 Ndikimet në tokë

5.3 Ndikimet në ajër

5.4 Ndikimet në florë dhe fauna

5.5 Ndikimet mbi trashgiminë arkeologjike, kulturore dhe historike

5.6 Ndikimet me natyrë ndërkufitare

5.7 Ndikimet në ujëra

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

1. HYRJE.

TË PËRGJITHËSHME.

Subjekti Alpin Sharku është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti L33421206N. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: Elbasan, Fshati Gostimë, ndërtesa 1-katëshe 100 m pranë godinës së komunës.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me ID:

ID 5.8, menaxhimi i mbetjeve: Magazinimi, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose cmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave.”

ID 10.4 industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve: Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë

Aktiviteti merr në konsideratë masat e nevojshme për të siguruar që menaxhimi i tyre të kryhet pa dëmtuar shëndetin e njeriut dhe pa i sjellë dëme mjedisit, vecanërisht:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masat teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Në këto aktivitete të subjektit janë punësuar disa punonjës për kryerjen e proceseve të përcaktuara në shërbimin teknik të automjeteve si dhe në demontimin e automjeteve të dalë jashtë përdorimit, dhe funksionimit e saj në vazhdimësi.

Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjesë të materialeve të ndryshëm në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë problem mjedisore të përkohshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës së bashku me zhvillimin e madh që është bërë në industri të ndryshme në mënyrë të ngjashme me të njëjtën shpejtësi

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

është rritur edhe sasia e mbetjeve nga përdorimi i të mirave material. Mbetjet industrial dhe ato urbane të patrajuara, emetimet e gazeve të dëmshme në atmosferë, përdorimi i kimikateve të reja pa marrë parasysh dëmet që mund ti sjellin mjedisit kanë sjellë problemet mjedisore me të cilat ne përballemi ditët e sotme

Kur parametrat mjedisorë nuk janë konform ligjeve, normave dhe rregullave të mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje të tij dhe prishje të ekuilibrave natyrorë nxitja e zbatimit të këtyre normave kërkon një përkujdesje nga ana e organeve legjislativë dhe vendimmarrëse në mënyrë që të rritet interesi si dhe detyrimi për ruajtjen e ekuilibrave natyrorë.

Kjo është arritur duke:

- Dhënë gjëndjen reale nga pikëpamja e ndikimit të këtij aktiviteti në mjedis.
- Analizuar faktorët pozitivë dhe negativë mjedisorë.
- Dhënë rekomandime për masat zbutëse dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Për këtë është shfrytëzuar:

- Informacioni bazë i zones.
- Dokumentacioni juridik dhe teknik i subjektit.

2. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

- Ligji nr.10431 Datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Urdhrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Vendim nr.805 datë 04.12.2003 “Për miratimin r listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis për të cilat kërkohet leje mjedisore”

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

- Udhëzim nr.1 datë 03.03.2009 “për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis”
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB
- Udhëzim për dokumentacionin e duhur për “Leje Mjedisore”
- Urdhëri nr. 321 datë 11.02.2014 “Për lejet Mjedisore”
- Udhëzim I MM dhe MF nr.7938 datë 17.07.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”
- Vendimit nr. 686 datë 29.07.20156 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- Ligji nr.12/2015 datë 26.02.2015 “Për disa ndryshime në ligjin 10440 datë 07.07.2011 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

3. PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT

3.1 POZITA GJEOGRAFIKE.

Objekti ku ushtron veprimtarinë ky subjekt gjendet nën juridiksionin administrativ të Njësisë Administrative Gostimë të Bashkisë Cërrik.



Teritori i administruar nga Bashkia e Cërrikut, kufizohet në veri me bashkitë Elbasan dhe Peqin, në jug-lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e kësaj bashkije është qyteti i Cërrikut.

Sipas Censurit të vitit 2011, në këtë bashki jetojnë 27445 banorë me densitet prej 144.71 banorë për km² ndërsa, sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 46652 banorë, me dendësi prej 189.65 banorë për km².

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 189.65 km². Ky teritor shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore në përgjithësi mes dy lumenjve, Shkumbin dhe Devoll.

Njësia Administrative Gostimë, është nën juridiksionin e Bashkisë Cërrik. Gërmimet arkeologjike të kryera në fushën e Pozhokut, ku janë gjendur një sasi e madhe materialesh, të cilët dëshmojnë se zona ku shtrihet Gostima ka qenë e banuar qysh në lashtësi.

Banorët e kësaj zone merren kryesisht me kultivimin e bimëve bujqësore si drithëra buke, perime e bime foragjere, pemëtari. Me të zhvilluara janë vreshtaria dhe ullishtat. Në fushën e blegtorisë mbarështrohen kryesisht gjedhe. Komuna ka rreth 3150 krerë lopë. Në të imta vendin kryesor e zë delja me 6300 krerë.

Ne territorin e Gostimës operojnë 100 biznese të vegjël. Fermerët i dërgojnë produktet për treg në mënyre individuale me mjete transporti të vetat ose përmes firmave.

Në këtë njësi administrative bëjnë pjesë shtatë fshatra që janë

- [Cartallozi](#) me 400 banorë.
- [Gostima](#) me 2180 banorë.
- [Gjyrala](#) me 2500 banorë.
- [Malaseji](#) me 550 banorë.
- [Shtëpanjë](#) me 2750 banorë.
- [Shtërmeni](#) me 3400 banorë.
- Shushica me 400 banorë.

3.2 KLIMA

Rajoni i përfshirë nën juridiksionin e Bashkisë Cërrik, përfshihet në zonën e klimës mesdhetare, me dimër të shkurtër e të butë dhe me verë të nxehtë e shumë të thatë. Temperatura **mesatare** e ajrit varion nga 6,7 °C në Janar deri në 23,4 °C në Korrik.

Era është një element i rëndësishëm klimatik për të cilën në përgjithësi mund të thuhet se kjo zonë karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 55 % të vitit) dhe shpejtësi mesatare minimale 1,2 m/sek gjatë verës dhe shpejtësi mesatare maksimale 2,1 – 2,4 m/sek. në dimër.

Erërat që fryjnë nga Veri – Lindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4,7 m/sek. Në pranverë çfaqet drejtimi i dytë dominues i erërave, Jug – Perëndim në 11,9 % të vitit. Ndikimi i këtyre erërave vazhdon të jetë i fortë edhe gjatë verës, ndërsa gjatë vjeshtës forcohen erërat Veri – Lindje.

Përsa i përket rreshjeve, pjesa më e madhe e tyre bie në periudhën e ftohtë të vitit dhe më pak në periudhën e ngrohtë për shkak të aktivitetit ciklonik. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit bie 65 % e shumës vjetore të rreshjeve dhe gjatë periudhës së ngrohtë 34 %. Shuma vjetore e rreshjeve është 1145 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i rreshjeve është 135 mm.

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

3.3 ARKEOLOGJIA

Teritori i administruar nga Bashkia Cërrrik shtrihet në zonën qendrore të vendit tonë. Pjesa më e rëndësishme e këtij teritori shtrihet ndërmjet shtretërve të lumenjve Shkumbin dhe Devoll.

Pjesa veriore e këtij teritori është pjesë e luginës së Lumit Shkumbin, në rrjedhën e mesme të tij dhe është ndërtuar kryesisht nga formacione molosike. Ajo është e formuar në periudhën e Kuaternarit dhe nga pikpamja gjeologjike në të takojmë :

- ✓ depozitimet e Oligocenit të Mesëm;
- ✓ depozitimet e Oligocenit të Sipërm;
- ✓ depozitimet e Tortonianit;
- ✓ depozitimet e Kuaternarit.

Shtrati i lumit Shkumbin, është i ndërtuar kryesisht nga depozitime lumore copëzore. Pjesa e teritorit që është e vendosur mbi një terracë lumore, është formuar nga depozitime poluviale të Lumit Shkumbin gjatë periudhës kuaternare (Q4pl), si pasojë e krijimit të shtratit të tij.

Kjo terracë lumore është e ndërtuar nga depozitime të përbëra nga formacione argjilore, konglomeratike aleorolitore me ranorë të rrallë. Në prerjen tërthore të depozitave vërehen alternime të këtyre depozitimeve. Këto depozitime litologjike dëshmojnë se kemi të bëjmë me formacione gjeologjike të një qëndrueshmërie mekanike të vogël.

- a. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zones.

Pjesë e rëndësishme e hidrografisë së këtij rajoni është Lumi Shkumbin dhe Lumi Devoll

Lumi Shkumbin shtrihet tërësisht brenda teritorit të vendit tonë. Burimet e tij fillojnë në fshatrat e rretheve Pogradec dhe Librazhd dhe grykëderdhja e tij është në detin Adriatik. Ai përshkon rrethet Librazhd, Elbasan, Peqin, Kavajë dhe Lushnjë.

Pjesa më e madhe e degëve të lumit Shkumbin përfshihen në zonën malore e kodrinore të pellgut ujëmbledhës ndërsa, një pjesë e vogël e tyre shtrihet në ultësirën adriatike. Ky lumë grumbullon ujrat e një teritori me karakter të theksuar malor çka e tregon dhe lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës e cila është prej 753 m mbi nivelin e detit.

Pellgu ujëmbledhës i lumit Shkumbin ka këto karakteristika:

- Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të Lumit Shkumbin është 2445 km².
- Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 753.2 m.
- Gjatësia 181.4 km.
- Gjerësia mesatare 13.4 km.
- Prurjet maksimale të lumit Shkumbin varrojnë nga 250 m³/sekondë në Qukës deri në 1700 m³/sekondë në Rrogozhinë.

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

Lumi Devoll buron në këmbë të [Gramozit](#), vazhdon rrjedhën e vet në veri drejt qytetit të [Bilishtit](#), për t'u kthyer më pas në perëndim nëpër grykën midis Malit të Thatë në veri dhe Moravës në jug, ku bashkohet në thellësi me lumin Osum, që buron po nga Gramozi, dhe formojnë së bashku Seman.

- i. Gjatësia 196 km.
- ii. Sipërfaqja e ujëmbledhëse është 3.139 km² dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit është rreth 960 m.
- iii. Prurja mesatare e Devollit është 49,5 m³/s, me modul rrjedhjeje të ulët prej 15.9 l/sek për km² dhe ushqehet kryesisht nga rrjedhjet sipërfaqësore.
- iv. Mineralizimi i ujit është 390 mg/l.
- v. Sasia e lëndëve të ngurta pezull që transporton është mesatarisht 8.7 milionë tonë në vit.
- vi. Temperatura e ujit ndryshon nga 5.7 °C në janar deri në 23.7 °C në gusht.

3.4 FLORA DHE FAUNA.

Flora dhe fauna e kësaj zone përbëhet nga ajo e butë që trajtohet nga banorët si dhe ajo e egër.

Tokat arë janë tërësisht të shfrytëzuara e të mbjella me bimë të arave, perime e bimë të cilat përdoren si ushqim për blegtorinë e imët si dhe shpendët. Vitet e fundit në zonat kodrinore ka marrë zhvillim të qëndrueshëm mbjellja dhe rritja e ullirit. Dominante në këtë zonë janë shkurret mesdhetare të përfaqsuara nga manaferra (*rubus fruticosus*). Bimësia barishtore është dhe deri diku e larmishme me dëndësi nga e rrallë deri në të dendur. Llojet kryesore të bimësisë barishtore që vegjetojnë në këtë zonë janë: grami (*cynodon dactylon*), hithra (*urtica dioica*), gjëmbat, (*cirsium spp*, *silybum spp.*), luledelja (*bellis perennis*) etj. Kjo bimësi është përgjithësisht spontane dhe varion nga e rrallë deri në mesatare. Pjesën më të madhe në pyje e zënë grumbujt pyjore të shkurreve. Cungishtet përfaqësohen nga qarri, bunga e bunga e butë dhe janë kryesisht grumbuj të rinj. Pyjet trungishte janë të lartë dhe zënë rreth 1.5 % të sipërfaqes totale pyjore me llojet si pisha e egër, dushqet dhe akacie

Kjo njësi administrative është e njohur për kultivimin e frutikulturës ku duhen përmendur pemëtarinë, si vreshta, qershi, ullishte dhe kumbulla. Vreshtaria është tendencë e kohëve të fundit dhe gjithnjë e më shumë njeh rritje.

Është një zonë që mbarështron kryesisht delen dhe lopën si dhe shpendët shtëpiake ku vendin kryesor e zë gjeli i detit. Në këtë zonë ndeshemi kryesisht me shpend vendas apo emigratorë, zvarranikë, etj. Zogjtë që jetojnë këtu janë trumcakë, mëllenja, etj. Ndër zvarranikët mund të përmendim breshkë toke mesdhetare (*testudo hermani*), gjarpërinj, hardhuca (*Lacerta viridis*), bretkosa të vogla të zakonëshme uji (*rona lessonae*), etj.

Speciet e faunës dhe të florës të takuara në këtë zonë, u kërkuan për t'u gjetur në speciet në rrezik të faunës dhe të florës të detajuara dhe të vlerësuara në "Libri i Kuq i Faunës Shqiptare" dhe "Libri i Kuq i Florës Shqiptare", dy libra këto të publikuar nga Ministria Mjedisit, respektivisht në vitin 2006 dhe 2007. Nga ky verifikim rezulton se, nuk kemi asnjë prej llojeve /specieve të pranishme në këtë zonë me llojet/speciet e listuar në këto libra.

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

3.5 Peisazhi dhe Topografia

Pejsazhi i zonës në të cilën zhvillohet projekti i propozuar është ai i një zone rurale. Gjatë viteve të fundit vërehet një zhvillim i linjave teknologjike prodhuese mbështetur kryesisht të biznesi familjar.

4. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti ALPIN SHARKU kryen aktivitetin “Oficinë dhe reparat mekanik”. Subjekti është regjistruar në QKB më datë 21/10/2013 me formë ligjore si person fizik, i pajisur me nr. Identifikimi NIPT: L33421206N me përfaqësues ligjor ALPIN SHARKU. Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij në Elbasan, Fshati Gostimë, ndërtesë 1-katëshe 100m pranë godinës së komunës.

Aktiviteti që ushtrohet për demontimin e pjesëve të ndryshme të makinave është instaluar në një sipërfaqe të konsiderueshme. Numri i njerëzve që punojnë në këtë aktivitet është rreth 5 punonjës.

Pra me këtë Përmbledhje Joteknike jepet informacion për projektin që është realizuar, vlerësimin e ndikimeve negative në mjedis si dhe proceset e punës që kryhen në këtë subjekt.

Vendndodhja ku subjekti ushtron aktivitetin ka koordinatat e mëposhtëme të përcaktuara sipas sistemit GAUSS-KRUGER.



DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

X	Y
X1 = 45 39 787.753	Y1 = 500 545.060
X2 = 45 39 802.593	Y2 = 500 568.720
X3 = 45 39 793.073	Y3 = 500 573.480
X4 = 45 39 819.533	Y4 = 500 614.780
X5 = 45 39 786.773	Y5 = 500 638.160
X6 = 45 39 749.113	Y6 = 500 569.560

Duhet theksuar se aktiviteti atë të kryerjes së shërbimeve elektro-mekanike të automobilave, si dhe atë të demontimit të automjeteve të dalë jashtë përdorimit, aktivitet që janë të përfshirë në kërkesat e Ligjit Nr. 60/2014 Për një ndryshim në Ligjin Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”. Shtojca I, për t’u pajisur me Leje Mjedisit Tipi B.

Raporti i paraqitur në vijim synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin në mjedisin e zonës ku punohet dhe më gjërë rreth saj, të projektit të propozuar për zbatimin i cili ka të bëjë me:

- i. kryerje e shërbimeve mekanike për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të tipeve dhe madhësive të ndryshme.
- ii. grumbullimin dhe demontimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit, ose në fund të jetës së tyre.

Trualli mbi të cilën zhvillohet kjo veprimtari nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi veç atij në shërbim të kësaj veprimtarie. Ky truall, karakterizohet nga një sipërfaqe e pothuajse e çveshur nga bimësia. Në të, nuk ka asnjë element infrastrukture. Ky truall gjendet në krahun e djathtë të rrugës automobilistike Gostimë-Gjyralë-Dëshiran, në afërsi të bregut të djathtë (sipas drejtimit të rrjedhës), të përroit Zalli i Gostimës. Shtrati i këtij prroi kalon në hapsirën gjeografike, ndërmjet rrugës automobilistike dhe kufirit të pronës së këtij investitori. Për të shkuar në objekt, shërben një degzim rruge prej rreth 300m, një rrugë fshati e pa shtruar dhe e paplotësuar me infrastrukturën inxhinjrike përkatëse. Kjo rrugë u shërben banorëve të kësaj lagjeje të fshatit Gostimë, për lëvizjen e tyre si dhe të mallrave tregtare dhe produkteve bujqësore. Në afërsi të këtij objekti, në anën perëndimore të tij, gjenden godina banimi dhe të shërbimeve tregtare etj.

Të dy këto veprimtari do të zhvillohen të ndara ose në përbërje të disa sektorëve organikë :

- Zyra teknike e administrative.
- Sektori i kryerjes së shërbimeve elektro-mekanike të automjeteve të tipeve dhe madhësive të ndryshme.
- Sektori i blerjes së automjeteve të dalë jashtë përdorimit ose në fund të jetës së tyre.
- Sektori i trajtimit të automjeteve jashtë përdorimit.
- Magazinimi i pjesë të cilat mund të ripërdoren.
- Magazinimit të mbetjeve të rrezikëshme dhe të atyre jo të rrezikëshme.

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

Çdo njeri prej këtyre sektorëve drejtohet nga një punonjës i cila ka eksperencën e duhur për të zhvilluar veprimtarinë e tij në mënyrë të pavarur. Të gjithë këta punonjës janë në komunikim të vazhdueshëm me drejtuesit teknik të subjektit.

Ambjentet e punës, sipërfaqet e pazëna me ndërtime si dhe godina ku zhvillohen operacionet e punës, plotësojnë kërkesat e pikës Nr 1 të Nenit 7 të Udhëzimit Nr 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.



Gjatë kryerjes së proceseve të punës subjekti përdor si lëndë të parë makinat e aksidentuara që nuk rregullohen më ose që rregullimi i tyre nuk sjell leverdi ekonomike pra makinat në fund të jetës.

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

Produkti përfundimtar i përfituar pas kryerjes së proceseve të punës janë:

- Baza e makinës (e cila cohet për skrap)
- Pjesë motorrike e gjenerike (Shiten subjekteve që merren me këtë aktivitet)
- Gomat dhe vajrat (merren nga subjekte të licencuara)
- Pjese plastike (depozitohen në pikën e grumbullimit të bashkisë Elbasan)

Kapaciteti i këtij subjekti është 240 ton/vit automjete ose rreth 100 automjete.

Të gjitha këto shërbime ofrohen nga një staf i kualifikuar në kryerjen e proceseve të punës dhe nga teknologjia më e fundit duke ofruar kështu shërbime të shpejtadhe cilësore. Ky subject është i fokusuar në vendosjen e standarteve personale përsa i përket shërbimeve duke projektuar me shumë përgjegjësi te cdo klient dhe partner që ka.

I orientuar drejt shërbimeve profesionale subjekti do të vazhdojë të ofrojë shërbime të tilla si demontimi i mjeteve dhe riciklimi total i tyre. Demontimi i makinave nënkupton heqjen e të gjitha pjesëve të papërorshme në një mjet motorrik, makinë furgon apo motor.

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

5.1 NDIKIMET NGA ZHURMA

Ndikimet nga zhurmat përfshijnë zhurmat e shkaktuara nga mjetet e punës që përdoren në këtë aktivitet. Duhet theksuar se kët cdo process pune është terësisht manual ndaj zhurmat e vetme shkaktohen nga lëvizja e mjeteve motorrike.

5.2 NDIKIMET NË TOKË

Mbeturinat e ngurta të cilat shkaktohen nga aktiviteti human, mbetje urbane të plastikës, qelqit, kartona etj janë të riciklueshëm dhe hidhen në kazanët e bashkisë. Të gjitha llojet e mbetjeve të tjera blihen nga subjekte të licencuara.

5.3 NDIKIMET NË AJËR

Subjekti ushtron një aktivitet të tillë i cili nuk gjeneron tymra, gaze, aroma, pluhura apo komponentë të tjerë të dëmshëm të kësaj natyre. Në ambiente e punës nuk ka as oxhak, as

DEMONTIM & SERVIS I AUTOMJETEVE

furra djegjeje dhe asnjë lloj procesi që lidhet me to. Kështu që ndikimi që subjekti ushtron në ajër është zero.

5.4 NDIKIMET NË FLORË DHE FAUNË

Aktiviteti zhvillohet në një ambient të hapur dhe brënda sipërfaqes së përcaktuar për këtë qëllim kështuqë nuk ka lidhje me mjedis tjetër, për rrjedhojë as derdhje të shkarkimeve apo mbeturinave që mund të shkaktojnë ndryshime në florën e faunën e zonës.

5.5 NDIKIMET MBI TRASHËGIMINË ARKEOLOGJIKE, KULTURORE DHE HISTORIKE

Aktiviteti që ushtron subjekti zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historinë apo tiparet arkeologjike.

5.6 NDIKIMET ME NATYRË NDËRKUFITARE

Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyrë ndërkufitare sepse ndodhet brënda territorit të bashkisë Elbasan dhe nuk ka kufijë tokësore me shtetet e tjera që kufizojnë Republikën e Shqipërisë.

5.7 NDIKIMET NË UJËRA

Nga zhvillimi i proceseve të punës së këtij subjekti nuk ka gjenerim të ujërave të ndotur. Të vetmet ujëra që shkarkohen nga subjekti janë ujërat sanitarë për larjen e ambjenteve. Këto ujëra shkarkohen në një kolektor e më pas në rrjetin e qytetit të Cerrikut.